



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/214

Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Banim Social dhe të Përballueshëm.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/214

Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/214

Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ "Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës".
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Qeveria e Republikës së Kosovës për Drejtor të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore, "Telekomi i Kosovës" Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - Z. Petrit Nahi, kryesues;
 - Znj. Rrezarta Pllana, anëtare;
 - Znj. Sajmie Thaçi, anëtare;
 - Znj. Lindita Toçi, anëtare.
- Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
- Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtor në Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore, "Kompania për Menaxhimin e Deponive" Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Afrim Konjufca, kryesues;
 - 1.2. Znj. Emine Telaku, anëtare;
 - 1.3. Znj. Valbona Shala - Thaqi, anëtare;
 - 1.4. Z. Petrit Pantina, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/214
Datë: 24.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i parcelave Nr.1504-16 dhe 1504-17 dhe Objektit/Ndërtesës ish prona shoqërore "Pallati i Shtypit - Nderm.Inf.Botuese", për nevoja të Depos Qendrore të Barnave dhe akomodim të administratës së Ministrisë së Shëndetësisë, ZK Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit për sipërfaqen e tokës, strukturat, investimet, pjesët aksesore, druajt të ndryshëm pyjor dhe frutor, të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat e bashkëngjitur këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën dhe investimet në prona për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtuesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues - Ministria e Shëndetësisë do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij vendimi, komfor legjislacionit në fuqi.
8. Subjekti Kërkues - Ministria e Shëndetësisë, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/214
Datë: 24.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore P. Sh "Progres" e cila preket nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit dhe Institucionit Korrektues në Prizren" për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës/Ministria e Drejtësisë, ZK Dushanovë, Komuna Prizren, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit për sipërfaqen e tokës, strukturat, investimet, pjesët aksesore, druaj te ndryshëm pyjor dhe frutor të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat e bashkëngjitur këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën dhe investimet në prona për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtuesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues - Shërbimi Korrektues i Kosovës/Ministria e Drejtësisë do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij vendimi, komfor legjislacionit në fuqi.
8. Subjekti Kërkues - Shërbimi Korrektues i Kosovës/Ministria e Drejtësisë, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/214
Datë: 24.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi dhe krijimi i të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi Nënstacionit NS 220/35/10(20) kV Malisheva dhe Linja Transmetuese 220 kV Dragobil", në Qytetin e Malishevës, Zona Kadastrale: Dragobil, Komuna Malishevë në dobi të Subjektit Kërkues/Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.), sipas tabelave të bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/214
Datë: 24.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit për nevoja të Terminaleve Doganore si më poshtë:
 - Terminali Doganor Hani i Elezit, ZK Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit;
 - Terminali Doganor Merdare, ZK Merdare, Komuna Podujevë;
 - Terminali Doganor Dheu i Bardhë, ZK Domoroc, Komuna Ranillugë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për dhënien në shfrytëzim për Ministrinë e Punëve të Brendshme, të pronës pyjore me numër të parcelave Nr. 602-0 dhe 603-0 ZK Jesenovik i Epërm, Komuna e Zubin Potokut dhe parcelat me Nr. 348-0 dhe 349-0 ZK Çeçevë, Komuna e Zubin Potok të evidentuar si DSŠG "Mokra Gora" Pogab Çeçevë, të objektit kryesor me objekte të tjera përcjellëse, pronë e Agjencisë Pyjore të Kosovës.
2. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese të Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Qela, U.D Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit Lokal, kryesues;
 - 1.2. Ilir Muçaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - 1.3. Fidan Dema, U.D Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Basri Hyseni, Ekspert i Jashtëm, anëtar;
 - 1.5. Dafina Gashi, Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në APK, anëtare.
2. Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 1. të Ligji Nr. 08/L-219 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.06/143 i datës 28 prill 2017 për themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 16/48 të datës 7 dhjetor 2020 dhe Vendimin Nr. 02/54 të datës 12 janar 2022, si në vijim:
 - Pika 1.9. e Vendimit Nr. 02/54 të datës 12 janar 2022 riformulohet: në vend të znj. Minire Begaj emërohet z. Kreshnik Oseku nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe të gjitha institucionet tjera që janë të përfshira sipas legjislacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 2.8. të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistika Zyrtare të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2023.
2. Raporti nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Zvicrës, e përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbi Programin "Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë, Faza 2".
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Inovacion.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese për Sekretar të Përgjithshëm të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në këtë përbërje:
 - Z. Osman Vishaj, Kryetar i KRPP-së, kryesues;
 - Z. Arben Krasniqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
 - Znj. Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë anëtare;
 - Z. Adem Bajgora, Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në MFPT, anëtar; dhe
 - Z. Valon Avdiu, Ekspert i jashtëm (Freelance Data Analyst), anëtar.
- Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në shërbimin Civil.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2024.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (këtu e tutje "Këshilli").
2. Këshilli është përgjegjës për monitorimin dhe sigurimin e efektivitetit të politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
3. Këshilli përbëhet nga:
 - 3.1. Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - kryesues i Këshillit;
 - 3.2. Ministrija e Ministrisë së Ekonomisë - anëtar;
 - 3.3. Ministri i Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve - anëtar;
 - 3.4. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - anëtar;
 - 3.5. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtar.
4. Këshilli kryen funksionin e monitorimit, koordinimit ndërministrorë dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë për hartimin dhe zbatimin e politikave nacionale për ndryshime klimatike dhe arritjen e targeteve klimatike, si në vijim:
 - 4.1. Monitorimi:
 - 4.1.1. Këshilli monitoron gjendjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë politikat sektoriale;
 - 4.1.2. Këshilli monitoron dhe aprovon raportet e zbatimit të politikave dhe strategjive që ndërlidhen me fushën e ndryshimeve klimatike;
 - 4.1.3. Këshilli monitoron zbatimin e "Planit të Veprimit për Përshtatjen e Ndryshimeve Klimatike" dhe të gjeturat publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
 - 4.1.4. Këshilli zhvillon raportin vjetor të monitorimit dhe raportimit dhe i propozon Qeverisë së Republikës së Kosovës planin vjetor të aktiviteteve që ndërlidhen me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike duke përfshirë masa, politika, strategji si dhe projekte;
 - 4.1.5. Këshilli propozon politika, masa, dhe projekte që kanë për qëllim avancimin e Agjendës së Gjellbër dhe përmasimin e përputhshmërisë me politikat kombëtare dhe obligimet ndërkombëtare;

- 4.1.6. Këshilli mban takime koordinuese me përfaqësues të Bashkësisë Evropiane (BE-së), Kombeve të Bashkuara (KB) dhe partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë zhvillimor në bashkërendimin e aktiviteteve dhe objektivave;
 - 4.1.7. Këshilli prezanton agjendën vjetore ndaj ndryshimeve klimatike para Qeverisë së Kosovës, partnerëve ndërkombëtarë dhe partnerëve vendor.
- 4.2. Koordinimi Ndërministror dhe Ndërinstitucional:
- 4.2.1. Këshilli ndihmon Qeverinë për të lehtësuar koordinimin efektiv në mes të gjithë akterve të sektorit publik dhe privat në lidhje me politikat klimatike dhe për të siguruar një monitorim, raportim dhe verifikim të cilësisë së lartë të të dhënave;
 - 4.2.2. Ministritë përgjegjëse brenda fushave të kompetencave përkatëse, mbledhin dhe mbajnë të dhëna për aktivitete, tregues specifikë, dhe informacione që lidhen me klimën, duke mundësuar monitorimin dhe koordinimin efektiv të masave dhe politikave, këto të dhëna janë në dispozicion të Këshillit;
 - 4.2.3. Këshilli bashkëpunon ngushte me Institutet kërkimore-shkencore, si dhe Universitetet publike ose private, në realizimin e matjeve, kërkimeve apo studime që ndërlidhen me ndryshimet klimatike, duke siguruar që masat dhe politikat janë të mirë informuara;
 - 4.2.4. Këshilli rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës miratimin e "Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë" i cili publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
 - 4.2.5. Ministria përmes Këshillit dorëzon "Kontributin Kombëtar të Përcaktuar" (NDC), Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratim, i cili publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
 - 4.2.6. Këshilli koordinon zbatimin e politikave ndërministrore me implikime ndërkombëtare duke përfshirë Planin për Energji dhe Klimë dhe Kontributin Kombëtarë të përcaktuar;
 - 4.2.7. Ministritë përgjegjëse brenda fushave të kompetencave përkatëse raportojnë në takime të rregullta lidhur me progresin në implementim të masave, politikave apo strategjive që ndërlidhen me fushën e ndryshimeve klimatike.
 - 4.2.8. Varësisht nga fushat të cilat i mbulojnë, kryesuesi i Këshillit mund t'i ftojë Ministrat e dikastere tjera për pjesëmarrje në këshill.
- 4.3. Bashkëpunimi Ndërkombëtar:
- 4.3.1. Këshilli e përfaqëson Kosovën në takime ndërkombëtare që ndërlidhen me tematikat e ndryshimeve klimatike;
 - 4.3.2. Këshilli i informon partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet raportit vjetor, lidhur me progresin e implementimit të aktiviteteve, masave dhe politikave si dhe agjendën vjetore për ndryshime klimatike, duke përfshirë Kontributin Kombëtarë të përcaktuar si dhe Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor;
 - 4.3.3. Rishikon dhe aprovon dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në konventa, protokolle dhe marrëveshje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike.
5. Funkcionet e Këshillit janë:
- 5.1. Këshilli takohet së paku një (1) herë në vit.
 - 5.2. Këshilli i raporton Qeverisë.
6. Në kuadër të Këshillit funksionon Sekretariati i Këshillit Kombëtarë për Ndryshime Klimatike (këtu e tutje "Sekretariati"), roli i të cilit është në ngritjen e kapaciteteve teknike lidhur me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

7. Sekretariati përbëhet nga:

- 7.1. Përfaqësuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (MMPHI) - kryesues;
- 7.2. Përfaqësuesi nga Departamenti i Energjisë, (ME) - anëtar;
- 7.3. Përfaqësuesi nga Zyra për Planifikim Strategjik, (MFPT) - anëtar;
- 7.4. Përfaqësuesi nga Departamenti Rrugorë, (MMPHI) - anëtar;
- 7.5. Përfaqësuesi nga Departamenti i Industrisë, (MINT) - anëtar;
- 7.6. Përfaqësuesi nga Departamenti i Pylltarisë, (MBPZhR) - anëtar;
- 7.7. Përfaqësuesi nga Divizioni për Ndryshime Klimatike (MMPHI)- anëtar;
- 7.8. Përfaqësuesi nga Departamenti i Politikave Sektoriale, (ZKM/ZBZh) - anëtar;
- 7.9. Përfaqësuesi nga Instituti Hidrometeorologjik, (MMPHI) - anëtarë;
- 7.10. Përfaqësuesi nga Departamenti për Planifikim, Ndërtim dhe banim, (MMPHI) - anëtar;
- 7.11. Përfaqësuesi nga Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, (MMPHI) - anëtar;
- 7.12. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (MMPHI)- anëtar;
- 7.13. Përfaqësues nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, (AME)- anëtar;
- 7.14. Përfaqësuesi nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, (MSh) - anëtar;
- 7.15. Përfaqësues nga Institucionet Akademike - anëtarë pa të drejtë vote;
- 7.16. Përfaqësues nga Institutet kërkimore-shkencore - anëtarë pa të drejtë vote;
- 7.17. Përfaqësues nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në Kosovë- anëtarë pa të drejtë vote;
- 7.18. Përfaqësues i shoqërisë civile - anëtarë pa të drejtë vote.

8. Sekretariati kryen këto funksione:


- 8.1. Përgatitë takimet e Këshillit;
- 8.2. Përgatitë raportet vjetore të progresit të implementimit të masave, politikave apo strategjive që ndërlidhen me fushën e ndryshimeve klimatike;
- 8.3. Monitoron implementimin e projekteve apo masave të partnerëve zhvillimor dhe përgatitë raporte vjetore për informimin e këshillit;
- 8.4. Mbledhë të dhëna për aktivitete, tregues specifikë, dhe informacione që lidhen me klimën, duke i mundësuar këshillit mirë informimin;
- 8.5. Mbështetë këshillin në përgatitjen e agjendës vjetore për ndryshime klimatike, identifikimin e masave, projekteve dhe strategjive që duhet të rishikohen;
- 8.6. Mbështetë këshillin në përfaqësim të institucioneve të Kosovës në takime vendore dhe ndërkombëtare;
- 8.7. Kryen punët profesionale, këshilluese dhe administrativo-teknike për nevojat e Këshillit;
- 8.8. Takohet së paku katër (4) herë në vit (çdo tre muaj); dhe
- 8.9. I raporton Këshillit.

9. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi janë institucionet e cekura në pikën 4. të këtij Vendimi.

10. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 07/54 i datës 12 janar 2022 për themelimin e Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike.

11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, pika 5. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 3,000,000.00 € (tre milionë euro), në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kod 205, nën-programi Bashkëfinancimi me Kuvendet Komunale me kod 42000, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: kapital "Programi i Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale" me kod 10041 në 55 (pesëdhjetë e pesë) projekte kapitale në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MMPHI-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti kapital: "Programi i Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale" me kod 10041 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
 - 2.1. Rikonstruimi i rrugës Gurët e Gjatë, Komuna e Fushë Kosovës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
 - 2.2. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Kuqicë, Qubrel, Vitak, Kastërrc, Klladërnice, Burojë, Vajnikë, Abri, Ticë, Mikushnicë, Polac, Makërmal dhe Rakinicë, Komuna e Skenderajt, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
 - 2.3. Ndërtimi i urave në fshatrat: Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Tërnafc, Tushilë dhe Kllodernicë, Komuna e Skenderajt, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
 - 2.4. Asfaltimi i rrugës Zlipotok-Baçkë-Brod, Komuna e Dragashit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
 - 2.5. Rikonstruimi i Trotuarit dhe shtegut për biçikleta në rrugën "Hasan Prishtina" deri tek Kosova A, Komuna e Obiliqit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
 - 2.6. Rruga qarkore Kamenicë K1, Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 55,000 € (pesëdhjetë e pesë mijë euro);
 - 2.7. Asfaltimi i rrugës Korça - Gmicë, Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 55,000 € (pesëdhjetë e pesë mijë euro);
 - 2.8. Asfaltimi i rrugës Berivojcë - Koretin (nga lagja Ibrahim) Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
 - 2.9. Ndërtimi i rrugës Sankoc-Harilaq (dalje ne magjistralen "Ibrahim Rugova"), Komuna e Drenasit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);

- 2.10. Rikonstruimi dhe Rehabilitimi i rrugës "Dëshmorët Babatinca", Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 87,000 € (tetëdhjetë e shtatë mijë euro);
- 2.11. Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës lidhëse Sfeqël - Dumosh, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.12. Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës lidhëse Bradash - Dobratin, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.13. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse nga Gurëthyesi deri në rrugën "Sahit Llalloshi", Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.14. Rikonstruimi i rrugës Ferizaj - Pleshinë, Komuna e Ferizajt, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.15. Asfaltimi i rrugës Babush i ri Cërnillë - Mirash, Komuna e Ferizajt, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.16. Asfaltimi i rrugës Crep - Ropotovë e Madhe, Komuna e Ranillugut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 100,000 € (njëqind mijë euro);
- 2.17. Ndërtimi - Zgjerimi i rrugës, urave dhe strukturave nga Deçani dalja për Pejë, Komuna e Deçanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 100,000 € (njëqind mijë euro);
- 2.18. Ndërtimi i Rrugës Unazore, Komuna e Junikut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 47,500 € (dyzetë e shtatë mijë e pesëqind euro);
- 2.19. Projekti i rehabilitimit të rrugës R220 nga Ura e Sitnicës deri te Llamkos, Komuna e Vushtrisë, alokimi për vitin 2024 në vlerë 52,700 € (pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind euro);
- 2.20. Projekti i rehabilitimit të rrugëve në fshatrat Akrashticë-Balincë, Komuna e Vushtrisë, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.21. Projekti i rehabilitimit të rrugës nga magjistralja N2 Dumnice e Ulët-Dumnice e Epërm, Komuna e Vushtrisë, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.22. Projekti i rehabilitimit të rrugës Dëshmorët e Kombit, Komuna e Vushtrisë, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.23. Asfaltimi i rrugës Carralevë - Pjetërshicë - Dugë, Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2024 në vlerë 70,000 € (shtatëdhjetë mijë euro);
- 2.24. Asfaltimi i rrugës lidhja e rrugës 12 qershori me rrugën William Wolker, Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2024 në vlerë 70,000 € (shtatëdhjetë mijë euro);
- 2.25. Ndërtimi i ndërlidhjes së rrugës Kolovicë - Sofali, Komuna e Prishtinës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 100,000 € (njëqind mijë euro);
- 2.26. Vazhdimi i ndërtimit të rrugës "Bajram Bahtiri" me 4 korsi, Komuna e Prishtinës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 100,000 € (njëqind mijë euro);
- 2.27. Kycja në rrethin e Lakrishtës (ndërlidhja e Unazës së qytetit me rrugën Prishtinë - Fushë Kosovë - Mitrovicë dhe rreth rrotullimin e Lakrishtës), Komuna e Prishtinës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 100,000 € (njëqind mijë euro);
- 2.28. Ndërtimi i rrugës "Guri i Matozit - Gradancë" në fshatin Mushtisht, Komuna e Suharekës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.29. Rikonstruimi i rrugës "Bahçelik", Komuna e Mamushës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.30. Mbushje e rrugëve fushore në komunën e Parteshit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 38,480 € (tridhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro);
- 2.31. Ndërtimi i Urave në fshatrat Llabjan (Brus, Abazaj), dhe Zebincë, Komuna e Novobërdës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 42,000 € (dyzetë e dy mijë euro);
- 2.32. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Novobërdës: Fshati Parallov Lagjet - Jakocëvi - Zivinci-Zenaj, Fshati Llabjan Lagjet: Te Fadili, Samia, Deli, Delovit, Zeqiraj, Gerbeshaj dhe Abazaj, Fshatin Kufcë, Fshati Makresh i Ulët dhe Makresh i Naltë, Fshati Pasjak Lagjja-Namanaj, Fshati Vllasali - Lagjja Sheqerovit, Fshati Novobërdë Lagjja - Koloni e Re, Fshati Kooznic Lagjja - Izvor dhe Behovit dhe Fshati Bushincë-Tirincë, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);

- 2.33. Asfaltimi i rrugës Kllokot - Mogillë, Komuna e Kllokotit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.34. Asfaltimi i rrugë "Ibrahim Rugova" nga Kishnica deri tek rruga Shashkovci (2250 m), bashkë me stazën te parku pishave (1000 m), rregullimi i kanalit të rrugës, si dhe lidhja e stazës me rrugën "Martirët e Kishnicës" (425 m), Komuna e Graçanicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 52,200 € (pesëdhjetë e dy mijë e dyqind euro);
- 2.35. Asfaltimi i rrugës "Nexhdet Petroviç" - Llapnasellë, Komuna e Graçanicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 46,000 € (dyzetë e gjashtë mijë euro);
- 2.36. Asfaltimi i rrugës te Shtëpia e Kulturës, Komuna e Graçanicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 16,000 € (gjashtëmbëdhjetë mijë euro);
- 2.37. Asfaltimi i rrugëve në Uglarë, Komuna e Graçanicës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.38. Ndërtimi i projektit të integruar të Bulevardit të qytetit - Gjilan, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 100,000 € (njëqind mijë euro);
- 2.39. Investimet në rehabilitimin e qarkores ekzistuese të Gjilanit, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.40. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ranatoc - Kokaj, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.41. Ndërtimi i rrugës Nekibe Kelmendi - Gjilan, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.42. Ndërtimi i rrugës Fidanishte 2 - Gjilan, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.43. Ndërtimi i rrugëve lidhëse në Livoq dhe Cernicë - Gjilan, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.44. Ndërtimi i trotuarit në Bresalc, Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.45. Ndërtimi i rrugës Gorancë - Krivenik, Komuna e Hanit të Elezit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 75,000 € (shtatëdhjetë e pesë mijë euro);
- 2.46. Asfaltimi i rrugës Kodra e Minatorëve: rrugë, kanalizim fekal dhe atmosferik, Komuna e Mitrovicë së Veriut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 20,000 € (njëzetmijë euro);
- 2.47. Asfaltimi i rrugës Lagja Bergjani: rrugë, kanalizim fekal dhe atmosferik, trotuar, Komuna e Mitrovicë së Veriut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 24,800 € (njëzet e katër mijë e tetëqind euro);
- 2.48. Asfaltimi i rrugëve në Kroin e Vitakut: janë disa rrugë, kanalizim fekal dhe atmosferik, Komuna e Mitrovicë së Veriut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 3,200 € (tre mijë e dyqind euro);
- 2.49. Asfaltimi i rrugëve tek Tre Rrokaqiejt: rrugë, trotuare, ndriçim, kanalizim fekal dhe atmosferik, parking, Komuna e Mitrovicë së Veriut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 20,000 € (njëzet mijë euro);
- 2.50. Ndërtimi i rrugëve "2 Korriku dhe Liria", Komuna e Istogut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.51. Ndërtimi i rrugëve në Dobrushë "Sarajeva", Komuna e Istogut, alokimi për vitin 2024 në vlerë 38,120 € (tridhjetetetë mijë e njëqind e njëzet euro);
- 2.52. Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall, Komuna e Rahovecit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.53. Ndërtimi i Urës mbi Lumin Sitnica, Komuna e Lipjanit, alokimi për vitin 2024 në vlerë 70,000 € (shtatëdhjetë mijë euro);
- 2.54. Asfaltimi i rrugës Poterq - Dugajevë, Komuna e Klinës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.55. Asfaltimi i rrugës për tek Ujëvara e Mirushës, Komuna e Malishevës, alokimi për vitin 2024 në vlerë 67,000 € (gjashtëdhjeteshtatë mijë euro);.

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009, nenit 17.4a të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në lidhje me nenin 6.8 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet par.1 i vendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës Nr. 02/58 i datës 2 shkurt 2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin Nr. 01/166 i datës 15 tetor 2023 si në vijim:
 - 1.1. Z. Valdrin Krasniqi, kryesues;
 - 1.2. Znj. Merita Kasapolli, anëtare;
 - 1.3. Znj. Valbona Raifi-Deshishku, anëtare dhe
 - 1.4. Z. Mustaf Pllana, anëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me kërkesë të Ministrisë përgjegjëse për Ndërmarrjet Publike të datës 22.07.2024 e për qëllim zbatimin e legjislacionit të aplikueshëm për barazinë gjinore, në përputhje me nenin 17.4a të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 6 të Ligjit Nr.05/L-009 lidhur me nenin 6.8 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.13/2022 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes dhe Dhënies me Qira të Pasurisë së Luajtshme dhe të Paluajtshme të Sekuestruar dhe të Konfiskuar.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/214
Datë: 24.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad-hoc i Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese: Drejtor (Ekzekutiv) i Përgjithshëm në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar/MD, në këtë përbërje:
 - Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, kryesuese;
 - Ismail Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, anëtar;
 - Fadile Dyla, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit anëtare;
 - Egzona Osmanaj, Eksperte e Jashtme, anëtare;
 - Nole Rexha-Kelmendi, U.D Udhëheqëse e Divizionit për Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, anëtare
- Obligohet Komisioni që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësit e tij siç përcaktohet në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë